



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Gashi EG" Sh.P.K. të datës 16.07.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Invertarizimi i kurorave dhe sipërfaqeve të gjelbërta" me nr. të prokurimit 616-24-6720-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Gashi Eg" Sh.P.K. të datës 16.07.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Invertarizimi i kurorave dhe sipërfaqeve të gjelbërta" me nr. të prokurimit 616-24-6720-5-2-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëjë korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Gashi Eg" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 16.07.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull ".

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: *“Tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale përkatësisht tek neni 9.1 dhe 9.2, ju keni kerkuar: “Bio-inxhinier ose te ngjajshem (niveli shkollimit master) – projekt menaxher. Minimum 3 vite eksperience pune. a. Me eksperience pune ne menaxhim te mjedisit, ose menaxhim te projekteve te ngjashme” dhe perveq kesaj keni kerkuar edhe “Dendrolog ose te ngjajshem (niveli shkollimit master). Minimum 5 vite eksperience pune a. Me eksperience ne njohjen dhe identifikimin e llojeve te bimeve” Duke pas parasysh se ne Kosove nuk ka drejtime te tilla si Bio-inxhinier apo Dendrolog dhe pasi si kerkese thuhet ose ndonje drejtim i perafert ne mendojme se keto dy kerkesa mund te mbuloohen nga nje Inxhinier i diplomuar ne Bujqësi. Andaj kerkojme nga ju si AK qe keto dy kriteret te rishikohen dhe te behen ndryshime ne menyre qe te mundesohet ofertimi i me shume kompanive. Ju gjithashtu keni kerkuar edhe: “Arkitekt I peisazhit (niveli shkollimit master). Minimum 5 vite eksperience pune a. Eksperience pune ne dizajnim te parqeve dhe menaxhim te hapësirave te gjelberta, njohuri ne bimesi.” Ne mendojme se kjo kerkese eshte e panevojshme dhe njeherit diskriminuese sepse ne Kosove nuk ka drejtim te tille si Arkitekt i peisazhit. Kerkojme nga ju si AK qe te largohet kjo kerkese sepse eshte favorizuese per OE te caktuar edhe diskriminuese per shume OE tjere”.*

Pas analizimit të pretendimeve ankimore të parashtruesit lidhur me kërkesat e DT për bio inxhinier ose arkitekt të peisazhit ose dendrolog është gjetur se këto profesione nuk janë tërësisht kompatible me programet e akredituara për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës. Rrjedhimisht këto kërkesa duhet të ndryshohen/plotësohen në dosjen e tenderit në të kundërtën kjo mund të përbëjë shkelje të nenit 7 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 17.07.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.